



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:136639

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05514938

2024:097674

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, si gjyqtar individual, duke vendosur në çështjen kontestimore juridiko-civile të paditëses H. T. nga Kaçaniku, të cilët me autorizim i përfaqëson Avokate M. K. B. nga Kaçaniku, kundër të paditurës K. K. , të cilën me autorizim e përfaqëson I. L. nga Kaçaniku dhe të paditurës Q. R. K. -M. M. P. H. , te cilën me autorizim e përfaqëson Avokatura Shtetërore, për çështjen kontestuese kompensimi i dëmit, në seancën kryesore të mbajtur me date 12.02.2024, në praninë e të autorizuarës së paditëses dhe të autorizuarës së të paditurës së parë, ndërsa më date 11.03.2024, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M

I.MIRATOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses H. T. nga Kaçaniku dhe DETYROHET e paditura K. K. që paditëses në emër të kompensimit për paluajtshmëritë të i'a paguaj shumat si në vijim:

I.a) Për pjesën e ngastrës kadastrale nr. ..., në sipërfaqe prej 201.42m² shumën prej 9,669.00€ dhe

I.b) Për pjesën e ngastrës kadastrale nr. ..., në sipërfaqe prej 11.45 m², shumën prej 550.00€.

-Në shumë të përgjithshme duke përfshirë pikën I.a dhe I.b shumën prej 10,219.00€.

II. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia paguaj shumën në pikën I të dispozitivit të aktgjyqimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,628.00€, të cilat pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktgjykimi.

III. DETYROHET e paditura që shumën nga pika –I- e këtij dispozitivi ta paguaj me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 17.08.2017 (data e ushtrimit të padisë në gjykatë), e deri në pagesën definitive.

IV. REFUZHET kërkesëpadia e paditëses H. T., nga Kaçaniku, kundër të paditurës Q. e K.- M. M. P. H. , me seli ne Prishtinë, për shkak se paditësja është tërhequr nga kërkesëpadia.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarës së saj si në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura gjyqësore, si dhe përmes precizimit të kërkesëpadiës ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta miratoj në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të i’u paguaj shumën prej 10,219.00€ në emër të dëmit në parcelat të cilat janë objekt I kontestit duke theksuar se e paditura me rastin e asfaltimit dhe zgjerimit të rrugës, ka përvetësuar, marr pjese nga parcela kadastrale nr. ..., me sipërfaqe prej 201.42m², e cila tani shfrytëzohet si rrugë e shtruar me zhavorr si dhe nga parcela kadastrale nr. ..., me sipërfaqe prej 11.45m², e cila tani shfrytëzohet si rrugë e asfaltuar, pa u zhvilluar procedura e shpronësimit.

E autorizuar e paditëses në fjalën përfundimtare ka theksuar se në bazë të nenit 5 të ligjit për rrugët “Komuna është autoritet për rrugët publike lokale dhe ato në vendbanime”, po ashtu me nenin 8 par 8,1 përcaktohet se “Ministria është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtim të rrugëve magjistrale dhe regjionale, ndërsa komuna është përgjegjëse për rrugët lokale dhe ato në vendbanime”, andaj nga provat e administruara rezulton se përgjegjëse për kompensimin e paluajtshmerisë së paditëses është e paditura e pare K. K. , andaj ndaj te paditurës së dyte M. e M., P. H. dhe I. heqim dore nga kërkesë padia.

Paditësja këtë shumë e ka kërkuar me kamatë prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet i ka kërkuar.

E paditura e pare K. K. , në përgjigje në padi po ashtu edhe ne seancat e mbajtura gjyqësore, ka kundërshtuar ne tërësi kërkesëpadinë e paditëses duke theksuar se asfaltimi i rrugës “...”- ..., segmenti nga lagja e ... e deri te kryqëzimi i rrugës “...”-Dushkaj, është financuar dhe mbikëqyr nga M. e I., dhe se K. K. nuk ka qenë palë nënshkruese e kontratës për hapjen dhe shtrimin e kësaj rruge, të njëjtës i mungon legjitimiteti në procedurë, andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzon në tërësi kërkesëpadinë si të pa bazuar ne ligj.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar

E paditura e dyte Q. e r.se K.-M. e M., P. H. dhe I., i ka propozuar gjykatës qe kërkesë padia e paditëses te hedhet ne mungese te legjitimitetit, duke theksuar se nuk ka elaborat për rrugën “...” dhe nuk është ne përgjegjësi të Ministrisë ngase nuk ka të dhëna se kjo rrugë menaxhohet nga Ministria.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe të gjykuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje kontestimore të kompensimit të dëmit, gjykata bëri administrimin e këtyre provave të shkruara ku u lexuan: certifikata e pronës me numër te lendes ..., e datës 27.07.2016, certifikate e vdekjes për M. T. me nr. serik V., certifikata e pronës me numër te lendes 513/2019, e datës 07.10.2019, njoftimi i MMPHI, i datës 15.12.20216, ekspertiza gjeodezike e ekspertit M. L., date 03.02.2023, raporti i vlerësimit punuar nga eksperti B. S., qershor 2023 se bashku me sqarimet e dhëna ne seancën e datës 27.11.2023

Pas vlerësimit me kujdes dhe profesionalizëm të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkërisht, e në bazë të dispozitave të nenit 8 të LPK-së, si dhe bindjes së lirë të gjykatë, kjo gjykatë për këtë çështje kontestimore vërtetoi këtë gjendje faktike:

Paditësja H. T. është pronare e parcelave kadastrale me nr. ... dhe se e paditura nga kjo parcelë ia ka përvetësuar hapësirën prej 1201.42m² dhe po ashtu është pronare e parc. nr. ..., në Z.K Kaçanik nga e cila parcelë gjithashtu e paditura gjatë punimeve në asfaltimin e rrugës ...-Lagja ..., ne Kaçanik, ka përvetësuar sipërfaqen prej 11.45m², vlere e të dyja sipërfaqeve të përvetësuarra arrin shumën prej 10.219,00€ dhe përgjegjëse për mbulimin e dëmeve të tilla është e paditura K. K. .

Faktet jo kontestuese:

a)Gjykata gjatë gjithë gjykimit është kujdesur që në këtë procedure civile të identifikoj faktet kontestuese dhe ato jo kontestuese, prandaj në këtë çështje juridike gjykata ka gjetur se në mesin e fakteve jo kontestuese janë: fakti se paditësja H. T. është pronare e parcelave ... dhe ..., në Z.K Kaçanik me faktin se këto dy parcela janë dëmtuar me rastin e asfaltimit të rrugës Stagovë-Lagja Dushkaja, prandaj gjykata me vetë faktin se këto rrethana apo fakte nuk ishin kontestuese gjate gjithë gjykimit, gjithashtu gjeti se të njëjtat po ashtu ishin të mbështetura në prova konkrete siç janë: certifikata e pronës me numër te lendes 513/2019, e datës 07.10.2019, ekspertiza gjeodezike nga eksperti M. L. e date 03.02.2023, raporti i vlerësimit punuar nga eksperti B. S., qershor 2023 se bashku me sqarimet e dhëna ne seancën e datës 27.11.2023.

Faktet kontestuese:

Në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurën kontestimore, kontestuese ishin faktet se dëmtimet e përshkruara si në gjendjen faktike, nuk ishin të shkaktuara nga ana e të paditurës, sepse e paditura K. K. nuk e ka bërë shtrimin e rrugës me asfalt, por këtë projekt e ka shtruar Ministria e Infrastrukturës andaj edhe e njëjta ka për obligim të I përgjigjet dëmeve eventuale.

Gjykata ka vendosur që të paditurën ta detyroj të paguaj shumën si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi për faktin se rruga "..."- Dushkaj, e shtruar me asfalt është rrugë e cila lidh dy lokalitete apo dy vendbanime të fshatit Stagovë me Lagjen Dushkaja të Kaçanikut, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës gjeodezike në faqen 4 paragrafi III të saj, ku eksperti ka gjetur se **“ sipërfaqja prej 152.76m² e parcelës 110-1 është e shtruar me asfalt dhe sipërfaqja prej 48.66m² e po të njëjtës parcelë është e shtruar me zhavorr por e përdorur si rrugë, ndërsa sipërfaqja prej 5.82m² e parcelës 110-2 është shfrytëzuar si asfalt, ndërsa sipërfaqja prej 5.63m² është shfrytëzuar si zhavorr por e përdorur për rrugë ”me çka në bazë të nenit 5 të Ligjit 2003/11 të Ligjit për rrugët ku thuhet se: “ Komuna është autoritet për rrugë publike lokale dhe ato në vendbanime”, si dhe lidhur me nenin 2 pika 5 të po të njëjtit ligj ku definohet kuptimi I rrugës lokale e që i përgjigjet rastit konkret, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.**

d. Faktin se dëmet e shkaktuara apo të ndodhura përbëjnë lartësinë e caktuar monetare të aprovuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, gjykata e ka bazuar po ashtu nga ekspertiza me

shkrim e ekspertit vlerësues B. S. në faqen 12 të ekspertizës me shkrim, si dhe në sqarimet e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e ekspertit në seancën e datës 27.11.2023 me anë të së cilës e ka përcaktuar se vlera financiare për pjesën e ngastrës nr. 110-1, te përvetësuar ne sipërfaqe prej 201.42m² (201.42m² x 48,00€/m²=9,669.00€), si dhe vlera financiare për pjesën e ngastrës nr.110-2 në sipërfaqe prej 11.45m² (11.45m² x 48.00€/m²=550.00€), prandaj gjykata kësaj prove I'a dha besimin sepse e njëjta është marrë nga një ekspert i lëmisë përkatëse i njohur për gjykatën si profesionist i fushës. Për më tepër ky ekspert ka qenë prezent gjatë gjykimit ku I'u janë parashtruar pyetje nga përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse e për të cilat eksperti ka dhënë sqarime të mjaftueshme, ku dhe gjithashtu kjo provë është në përputhje me provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata pas analizimit të padisë, provave të bashkangjitura padisë, dhe provave të tjera të nxjerra gjatë këtij procesi gjyqësor dhe pretendimeve të palës paditëse, kërkespadinë e paditësit e ka miratuar si të bazuar dhe e ka detyruar të paditurën që të i'a paguaj shumën si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata e ka detyruar të paditurën që ta paguaj këtë dëm sepse me veprimet e të paditurës, paditëses i është shkaktuar ky dëm. Me rastin e vendosjes Gjykata mori parasysh dispozitën e nenit 136 par.1 të LMD-së me të cilën dispozitë është paraparë se *“kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, po ashtu kjo gjykatë e pati në konsideratë edhe nenin 169 par 3 i LMD-së ku thuhet se: *“Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t`ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit”*, andaj gjykata në rastin konkret vlerëson se detyrimi për kthimin në gjendje të mëparshme nuk do të ishte i përshtatshëm për faktin se nga provat e administruara janë vërtetuar dëmtime të kulturës bujqësore si pasojë e asfaltimit të rrugës e për të cilat kthimi në gjendjen e mëparshme do të ishte po ashtu me pasojë për shkak të kërkesave eventuale për fitim të humbur, andaj në rastin konkret kompensimi I tërësishëm është dhe mbetet për gjykatën forma më ekonomike dhe më e drejtë duke u bazuar ne nenin 169 par 4 i LMD-së sepse forma e tille e kompensimit të dëmit është më e përshtateshe dhe më reale ne raport me dëmin e pësuar .

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike e cila u vërtetua në mënyrë të plotë dhe të drejtë që rezultoi nga të gjitha provat e nxjerra dhe të vlerësuar, gjykata vlerëson se janë

eliminuar të gjitha faktet kontestuese për vendimmarrje dhe kërkesëpadinë e paditëses e miratoi në tërësi si të bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, duke zbatuar edhe dispozitën e nenit 323 të LPK-së.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit, Gjykata me kërkesën e paditëses dhe në bazë të nenit 382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditëses në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën prej 8% duke filluar nga data 17.08.2017 (data e ushtrimit të padisë në gjykatë), e deri ne pagesën definitive si dhe duke u bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 265/20 të datës 02/12/2020 që ka të bëjë me llogaritjen e kamatës në rastet e kompensimit të dëmit material.

Gjykata e refuzoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses kundër të paditurës, Q. R. K. – M. e M., P. H. dhe I.s, për shkak se paditësja ne seancën e shqyrtimit kryesor e ka tërhequr kërkesëpadinë, ndaj te paditurës

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila kërkoi nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar. Këtyre theksimeve gjykata u'a dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse është fakt i ditur se me veprimet e të paditurës ka ardhur deri tek shkaktimi i dëmit. Këto fakte janë sqaruar në mënyrë detale në pikat e shënuara më lartë të arsytimit dhe nga ekspertiza të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata i analizoi pretendimet e palës së paditur e cila i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar e njëjta nuk është nënshkruese e kontratës për hapjen dhe asfaltimin e rrugës dhe të njëjtës i mungon legjitimiteti në procedurë. Këto theksime gjykata nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse nuk kishin ndikim që të vendosej ndryshe dhe e paditura ka detyrim që te kompensoj paditësen ***në bazë të nenit 5 të Ligjit 2003/11 të Ligjit për rrugët ku thuhet se: “Komuna është autoritet për rrugë publike lokale dhe ato në vendbanime”***, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata e detyroi të paditurin që paditëses të i'a paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,628.00€, edhe atë shumën prej 208€ për përpilimin e padisë, shumën prej 1,620.00€ për 6 seanca gjyqësore, shumën prej 500€ për ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë, shumën prej 200€ për ekspertizën e ekspertit vlerësues dhe shumën prej 100 € në

emër të taksës për padi (të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.1/2017 të Këshillit Gjyqësorë), gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura dhe rezultatet e përgjithëshme të procedurës kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

2019:136640 prej datës 12.02.2024

Gjyqtari

Burhan BERISHA

UDHËZIME JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.